



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Kuvendi Komunal Rahovec/Skupština Opštine Orahovac/Municipal Assembly Rahovec



PROCESVERBAL

Mbledhja e rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa, e mbajtur më **18.04.2018**, me fillim në ora **10.15**.
Mbledhjen e kryesoi kryesuesi i Kuvendit **Afrim Dina**.

Kryesuesi – Fillimisht më lejoni të përshëndes, Nënkryetarin Fatmir Iska, delegatët e pranishëm në këtë seancë të KPF-së, monitoruesit e KFORIT, OSBE-së, drejtorët e drejtorive dhe të gjithë të pranishmit e tjerë. Kjo është mbledhjen e dytë e KPF-së për vitin 2018. Materialin besoj se keni marrë të gjithë me kohë, kuorum për mbajtjen e mbledhje ka, Ju paraqes rendin e ditës të paraparë për këtë mbledhje:

REND DITE

1. **Aprovimi i Procesverbalit nga Mbledhja e Kaluar,**
2. **Shqyrtimi i Raportit 3 mujor financiar të vitit 2018,**
3. **Shqyrtimi i raportit të auditimit të brendshëm për DKA-në,**
4. **Formimi i Komisionit Komunal të Aksionarëve për Ndërmarrjen Publike – Stacioni i Autobusëve,**
5. **Shqyrtimi i Propozimit për dhënien e pronës së paluajtshme Komunale në shfrytëzim afatshkurtër personave fizik dhe juridik,**
6. **Shqyrtimi i Propozim Vendimit për ndarjen e mjeteve për Festivalin Folklorik Kombëtar “Anadrinia Jehon” Dejnë”,**
7. **Të ndryshme.**

Kryesuesi – Fillimisht dua që të ju njoftoj se na janë kthyer konfirmimet e ligjshmërisë nga MAPL-ja për ndërrimin e anëtareve të KPF-së dhe Komitetit për Komunitete, ku që të dyja janë konstatuar si pozitive. Kemi edhe dy pika shtesë për këtë mbledhje që na kanë ardhur si urgjencë për të qenë pika të rendit të ditës në KPF, ku njëra pikë na ka ardhur nga Drejtoria për Ekonomi Zhvillim dhe Turizëm, e ajo është: Shqyrtimi i Propozimit për dhënien e pronës së paluajtshme Komunale në shfrytëzim afatshkurtër personave fizik dhe juridik. Si pikë e dytë shtesë që duhet të hyjë sot është: Shqyrtimi i Propozim Vendimit për ndarjen e mjeteve për Festivalin Folklorik Kombëtar “Anadrinia Jehon” Dejnë”. E qes në votim Rendin e ditës me këto dy pika shtesë: Konstatoj se në mënyrë unanime është aprovuar rendi i ditës. Kalojmë në pikën e parë të rendit të ditës:

1. **Aprovimi i Procesverbalit nga Mbledhja e Kaluar.**

A ka dikush ndonjë vërejtje sa i përket Procesverbalit nga Mbledhja e kaluar, nëse jo e qes në aprovim procesverbalin: Konstatoj se në mënyrë unanime është aprovuar procesverbali. Kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës:

2. **Shqyrtimi i Raportit 3 mujor financiar të vitit 2018.**

Afrim Limani – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, Më lejoni që në fillim të ju kërkoj falje që ky material ju ka ardhur me vonesë, arsyetimi nga ne është për shkak se Drejtoria e Financave nuk ka mundur që para datës 10 të muajit të i nxjerrë raportet financiare, këto raporte duhet që të koordinohen edhe me departamentin e thesarit. Kjo fatkeqësisht do të ndodhë edhe herrave të tjera sepse ne siç e thash nuk mundemi të nxjerrim para datës 10, prandaj shpresoj se do të më mirëkuptoni. Raporti financiar i vitit 2018 përbëhet nga të hyrat dhe realizimet e buxhetit ku për këto 3 muaj kemi një inkasim të të hyrave prej 251,324.88 €, nëse e bëjmë krahasimin me vitin e kaluar të periudhës së njëjtë kemi një ndryshim pozitiv prej

8,178.00 €. Në faqe nr. 4 i kemi prezantuar edhe të hyrat se sipas viteve duke filluar nga viti 2012 deri në vitin 2018 dhe jemi duke parë se viti 2018 ka një progres në krahasim me vitet e kaluara. Në faqe nr. 6 i kemi të prezantuar të hyrat nga gjrobat e trafikut dhe gjrobat e gjykatave, të hyrat nga gjrobat e gjykatave deri më tani ende nuk e kemi mare ndonjë raport, gjithashtu edhe në periudhën e njëjtë të viti të kaluar nuk ka pasur raport nga gjrobat e gjykatave. Kurse gjrobat e trafikut janë në shumën prej 17,425.00 € kurse në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar kanë qenë 19,925.00 €, ku në total të hyrat kanë qenë 268,749.88 €. Në faqe nr. 5 e kemi bërë edhe prezantimin e të hyrave sipas kategorive ekonomike ku nëse e bëjmë një analizë do të shohim se progresi më i madhe është në kuadër të tatimit në pronë ku ka një rritje prej 12,441.00 €. Si e hyrë tjetër më e suksesshme është edhe taksa për ushtrimin e veprimtarisë me një ndryshim pozitiv nga raporti i vitit të kaluar në shumën prej 6,699.00 €, kurse ngecje ka në të hyra nga qiraja e vendosur nga objektet tregtare ku kemi minus 19,629.00 €. Në faqe nr.8 i kemi të prezantuar rezultatet apo statistikën e tatimit në pronë, ku i kemi regjistruar e reja gjithmonë në raporte me vitin e kaluar. Në faqe nr.9 e kemi bërë raportin e shpenzimit të buxhetit sipas programeve të drejtorive dhe sipas kategorive, ku jemi duke parë se kemi një shpenzim total të buxhetit deri në këtë periudhë në shumën prej 3,220,000.00 €. Gjithashtu në këtë faqe e kemi bërë edhe prezantimin e shpenzimeve sipas kategorive ekonomike, ku në total buxheti i shpenzuar për këto 3 muaj 23.51 %, gjithashtu e kemi edhe tabelarin e shpenzimeve sipas komunalive, ku si total shpenzimet për komunalë arrijnë vlerën prej 52,509.00 €. Krejt në fund e kemi paraqitjen e shpenzimeve sipas kategorive ekonomike mallra dhe shërbime, shumica e shpenzimeve që figurojnë në këtë periudhë 3 mujore mbi 90 % janë shpenzime të cilët i kemi bërë gjatë bartjes së pagesave të borxheve, nuk e kam parë të arsyeshme se kam mundur që ta shtojë edhe një shtyllë këtu në këtë raport dhe ti paraqes të gjitha ato shpenzime që janë bartur nga viti i kaluar por këtë besoj se do ta bëjë në raportin 6 mujor dhe raportin vjetor. Në këtë raport nuk e kam përfshirë edhe raportin e zyrës së prokurimit nuk e kam parë të arsyeshme sepse gjatë kësaj periudhe nuk ka pasur ndonjë aktivitet kjo zyre, por në raportin 6 mujor nuk do të mungojë ky raport.

Florije Boshnjaku - Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, Falënderoj drejtorin që na ka sjellë raportin, këtë raport e kam shfletuar edhe në shtëpi ku kam shikuar disa çështje që janë shumë me rëndësi, por ajo që më shqetëson më së shumti në lidhje me shpenzimet dhe planifikimet por në shumë shpejtë do të kemi qarkoren buxhetore për vitin 2019 dhe aty do ta kemi kornizën se sa do të kemi. Por të hyrat vetanaka që janë paraparë për vitin 2018 janë 1,600,000.00 €, i nderuari Drejtor si mendoni ju tani për vitin 2019 kur është duke u parë se janë realizuar vetëm 16 % sepse nuk ka mundësi që të realizohen 1,600,000.00 € si do të jetë planifikimi për vitin 2019, a do të zvogëlohen këto të hyra për vitin 2018 duke parë që në vitin 2017 planifikimi ka qenë 1,200,000.00 € kurse në vitin 2018 për 400,000.00 € janë rritur. Pastaj tek qiraja e objekteve tregtare mendoj se vitin e kaluar janë arritur rezultatet ose të hyrat më të mëdha sepse borxhet që kanë qenë janë akumuluar në vitet e tëra dhe pastaj një pjesë në ju kemi falur dhe pagesa që i ka mbetur është paguar.

Fehmi Cena – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, tek faqja 6 e këtij raporti financiar të hyrat e realizuara për këtë periudhë 3 mujore në shëndetësi jemi duke parë edhe këtu kemi një rrënjë të të hyrave në krahasim me 3 mujorin e parë të vitit 2017, në vitin 2017 kanë qenë më shumë se 10,000.00 € kurse në vitin 2018 në 3 mujorin e parë janë më shumë se 8,000.00 €, mendoj se çdo ku kemi rrenje duhet të shikohet nga dikasteret përkatëse në mënyrë që mos të kemi rrënjë dhe të i jepet më shumë rëndësi të hyrave vetanake duke e ditë që është shumë me rëndësi për zhvillimin e Komunës dhe shoqërisë në përgjithësi. Znj. Florije i përmendi disa rrënjë në disa kategori ku diku kishim një rrënjë prej 16% dhe besoj se kjo është një rrënjë shumë e madhe, prandaj propozoj që të punohet më shumë në këtë drejtim. Përndryshe raporti është mjaftë kompleks sado që ne e lexojmë prapë ka disa gjëra që nuk mundemi të i kuptojmë sepse nuk jemi të gjithë me profesion financier. Për shëndetësi propozoj që në mbledhjen e Kuvendit në këtë faqe të ekzistoj edhe planifikimi sa janë paraparë për një vit dhe për 3 mujor sepse kjo do të jetë një pasqyrë më e saktë.

Florida Bajraktari – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, pyetje ime për Drejtorin e Financave është tek raporti i shpenzimeve sipas kategorive ekonomike dhe krahasimi i tyre janar – mars për vitin 2017 – 2018, jam duke vërejtur që janë bërë disa shpenzime me të mëdha p.sh: Tek shpenzimet e udhëtimit brenda vendit kemi një diferencë të shpenzimeve prej 1,849.00 €, pastaj tek shërbimet postare edhe këtu kemi një diferencë të madhe në krahasim me 3 mujorin e vitit 2017 ku kemi një diferencë prej 4,803.00 €, pastaj tek shërbimet e shtypit jo markë në vitin 2017 nuk ka pasur fare shpenzime kurse në vitin 2018 kemi shpenzime 1,021.00 €, kisha pas dëshirë që të na tregoj drejtori i Financave pse ka ndodhur kjo diferencë e shpenzimeve.

Afrim Limani – E nderuara znj. Florije e bëri pyetjen për mos realizimin e të hyrave në raporte me planifikimin, e nderuar po të flasë në bazë të përvojës së kaluar që e kam pas, zakonisht ne si drejtori ose ekzekutiv planifikimin e bëjmë në baza reale gjithmonë në krahasim me vitin e kaluar dhe me tendencë të rritjes deri në 10 %, por pa marrë parasysh ne çka bëjmë Ministria e Financave gjithmonë na ka dërguar rekomandime se ne duhet që të risim të hyrat vetanake ku ka ndodhur që është kërkuar edhe 300,000.00 € ose edhe 400,000.00 € që na është kërkuar, ne e kemi diskutuar edhe në mandatin e kaluar këtë temë, ne nuk kemi çka të bëjmë ata na japim direktivat dhe ne duhet që të pajtohemi me atë, e di se nuk kemi me pas mundësi që ta realizojmë këto të hyra edhe këtë mandat sepse Komuna e Rahovecit nuk ka kapacitete të mjaftueshme duke e ditur gjendjen e bizneseve dhe shumë faktorëve të tjerë. Tek qiraja e objekteve e thatë se është një ndryshim, tek qiraja janë të hyrat kryesisht nga reklamat e ndryshme, ka ndodhur që operatori nuk e ka paguar në këtë 3 mujorë edhe pse kjo paguhet një herë në vit por shpresojmë se do ta paguaj në 3 mujorin e dytë. I nderuari Doktor pajtohem me atë që e the sepse edhe unë dhe gjithë ju kemi dëshirë që të hyrat në shëndetësi të rriten ma shumë, Drejtori i Shëndetësisë është i njoftuar dhe besoj se do të mirën masat që të hyrat në shëndetësi të rriten më shumë. Kurse sa i përket planifikimit që e thatë harrova të ju them se është një shtyllë në faqen tjetër ku janë cekur realizimet e të hyrave sipas drejtorive, në këtë raport 3 mujor nuk e kam bërë por do ta bëjë në raportin 6 mujor dhe aty do të ceken edhe shënimet më detale sepse gjatë kësaj periudhe 3 mujore nuk ka pasur edhe shumë aktivitete. E nderuara znj. Florida Bajraktari pyeti për disa shpenzime si ato brenda vendit, shpenzimet postare dhe ato të marketingut. E nderuar shpenzimet e udhëtimit brenda vendit janë thuajse 90% të shpenzimeve nga borxhet që i kemi bartur, kjo nuk do të thotë se edhe ne nuk kemi bërë, këto shpenzime janë kryesisht bartja e nxënësve që bëhet nëpër disa shkolla, Shpenzimet Postare është e vërtet se ne e kemi trashëguar një borxh, këto janë shërbime që posta e bënë shpërndarjen e faturave të tatimit në pronë, ne e kemi trashëguar një borxh prej 12,000.00 € prandaj jemi detyruar që të paktën ta zbusim këtë borxh, kurse shërbimet e marketingut nuk kemi pasur në këtë periudhë 3 mujore.

Kryesuesi – Ju faleminderit të gjithëve, kalojmë në pikën e radhës:

3. Shqyrtimi i raportit të auditimit të brendshëm për DKA-në.

Binak Kryeziu – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, raporti final për DKA-në është si rutinë e planit vjetor të vitit 2017, ky raport është i pari që është audituar në muajin shkurtë fushëveprimi i auditimit ka qen viti 2016, në këtë raport janë përfshirë 6 objektiva dhe 4 rekomandime, për ma shumë e keni raportin para vete për çdo pyetje që keni jam këtu për të ju përgjigjur.

Kryesuesi – A ka dikush të shtoj diçka sa i përket kësaj pike, nëse jo atëherë kalojmë në pikën e radhës:

4. Formimi i Komisionit Komunal të Aksionarëve për Ndërmarrjen Publike – Stacioni i Autobusëve.

Isak Hoti – Shef i zyrës ligjore, Përshëndetje për të gjithë të pranishmit në sallë, është bërë një propozim nga Kryetari i Komunës për formimin e Komisionit Komunal të aksionareve për ndërmarrjen publike Stacioni i Autobusëve në Rahovec, ku me Ligjin për Ndërmarrjet Publike Nr.03/L 087 dhe plotësim ndryshimi i Ligjit Nr. 04/L 110 ku e përcakton se Komuna është aksionare 100% e Stacionit të Autobusëve. Edhe në të kaluarën është bërë një përpjekje për këtë por kanë mbetur punët në gjysme, tani me propozimin e delegatit z. Rexhep Oruqi është bërë një propozim i cili do të shndërrohet në vendim në Kuvend për formimin e Komisionit Komunal të aksionarëve në Komunën e Rahovecit, propozimi i parasheh kushtet dhe procedurat se si do të udhëhiqen aksionet e stacionit të autobusëve në Rahovec, një anëtar do të propozohet nga Kryetari i Komunës, këtë e parasheh ligji përkatësisht neni 5 dhe neni 16, kurse dy anëtarët e tjerë propozohen nga Kuvendi të cilët duhet të janë delegat e Kuvendit të Komunës. Detyrat dhe përgjegjësit i kanë të paraparë në bazë të ligjit dhe do të fillojnë ti i marrin vendimet e veta nga momenti kur të hyjë vendimi në fuqi.

Fehmi Cena – Pyetje ime është a ka mundësi të na sqaroni se di ka funksionuar deri më tani Stacioni i Autobusëve, thjeshtë si është menaxhuar kjo ndërmarrje.

Isak Hoti – Së pari i nderuari z. Cena ne nuk e dimë se si është menaxhuar përderisa nuk është formuar Komisioni i Aksionarëve, këta 3 persona që i zgjedh Kuvendi dhe votohen këtu i kanë të drejtat e kompletuara për verifikimin e gjendjes faktike, përfshirë pronën Komunale, borxhet aktuale që i ka kjo ndërmarrje, numri i stafit të punëtorëve. Pra siç e thash nga momenti i hyrjes në fuqi të këtij vendimi të gjitha kompetencat i merë ky Komision i aksionarëve dhe të vetmit organ që i përgjigjen është Kuvendi i Komunës, ata do të duhet që të bëjnë një raport, pastaj ata kanë të drejtën të kërkojnë bërjen e auditimit, pastaj konform ligjit për ndërmarrje shoqërore formohet bordi i drejtorëve ku 4 persona do të zgjidhen me konkurs kurse njërin e zgjedh bordi i drejtorëve. Pra pasi të hyj në fuqi ky vendim do ta dimë gjendjen faktike të Stacionit të Autobusëve.

Nënkryetari - Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, desha të bëjë vetëm një sqarim, në vitin 2015 atëherë nga ish anëtarët e Kuvendit është formuar një Komision i cili ka bërë verifikimin e gjendjes faktike në qe kemi qenë Kuvendar edhe në legjislaturën e kaluar e dimë, aty ka pasur shumë borxhe si për rrymë, ujë, mbeturina dhe sipas atyre nuk pa pasur aty kurrfarë menaxhimi dh me këtë regjistrim të kësaj gjendje faktike ai komision e ka bërë një raport për Kuvend ku është diskutuar dhe aty është mbyllur ajo etapa e çështjes së Stacionit të Autobusëve, nuk është ndërmarrë kurrfarë veprimi sa më kujtohet ka qen anëtar nga LDK-ja z. Lirih Berisha, nga PDK-ja Fehim Fetoshi më duket nuk e di saktë, ata e kanë ndërprerë punën për shkak çështjes së pagesave që me shumë të drejtë e kanë pasur që kanë kërkuar të paguhen për arsye se një punë që e bënë anëtar i Kuvendit i cili është në një Komision e ka të drejtën e plotë që të kompensohet për punën e vetë që e kanë bërë, tani ky komision i cili do të formohet po ashtu duhet që të bëjë regjistrimin e gjendjes faktike se si është në teren sepse çështja është se si me e bartë atë ndërmarrje publike në pronësi ose në menaxhim të Komunës dhe pastaj të formohet ky bord në mënyrë që të ketë një menaxhim ma të mirë dhe me e pas një kontroll në ndërmarrjen publike që ne synojmë me e kthye në menaxhim të Komunës. Shpresojmë se një herë e mirë kjo ndërmarrje do të këndellët dhe ata punëtor që punojnë aty një herë e mirë të i marrin ato paga me rregull sepse sipas informatave që i kemi edhe në paga ka borxhe ndaj punëtorëve, pra të ecim më tutje në këtë proces në mënyrë që mos të demolohet më tutje kjo ndërmarrje në Rahovec.

Kryesuesi – E qes në votim pikën e katërt Formimi i Komisionit Komunal të Aksionarëve për Ndërmarrjen Publike – Stacioni i Autobusëve: Konstatohet se në mënyrë unanime është aprovuar pika e 4 (katërt) e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e radhës:

5. Shqyrtimi i Propozimit për dhënien e pronës së paluajtshme Komunale në shfrytëzim afatshkurtër personave fizik dhe juridik.

Artan Asllani – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, kërkoj falje që e keni pranuar këtë pikë me vonesë, por arsyeja është se i ka skaduar kontrata pikës grumbulluese për pemë dhe perime në fshatin Xërxë , Komuna ka pasur si projekt vital zhvillimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim personave fizik dhe juridik në periudhën afatshkurtër deri në 15 vite, për të njëjtin aktivitet për grumbullimin e pemëve dhe perimeve, besojmë se kjo i ndihmon bujqit në krijimin e kushteve më të mira si dhe i lehtëson në shitje dhe transportim fermerëve si brenda ashtu edhe jashtë territorit të Kosovës. Për më shumë e keni materialin që ju kemi shpërndarë, nëse keni ndonjë pyetje jam këtu për të ju përgjigjur.

Kryesuesi – Nëse nuk ka askush të shtroj diçka sa i përket kësaj pika e qes në votim pikën e 5-stë Shqyrtimin e Propozimit për dhënien e pronës së paluajtshme Komunale në shfrytëzim afatshkurtër personave fizik dhe juridik: Konstatohet se në mënyrë unanime është aprovuar pika e 5 (pestë) e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e radhës:

6. Shqyrtimi i Propozim Vendimit për ndarjen e mjeteve për Festivalin Folklorik Kombëtar “Anadrinia Jehon” Dejnë”,

Nënkryetari – Është pik shtesë e rendit të ditës pasi është pikë me urgjencë për arsye se ky festival organizohet me datë. 12, 13, 14 Maj ku besoj se edhe në mbledhjen e Kuvendit Komunal do të miratohet, siç e dini ju Kryetari i Komunës ka të drejtë sipas rregullores me i nda mjetet deri në 2,000.00 € dhe nëse kalohet kjo shumë atëherë për atë vendos Kuvendi i Komunës. Ne kemi pasur edhe një takim me kryesin e këtij festivali ne kërkojmë nga ju mbështetje për në Kuvend shuma të cilën do e propozoj Kryetari do të jetë 3,500.00 € - 4,500.00 € po ju si anëtar të Kuvendit Komunal besoj se do ta aprovoni këtë propozim në mënyrë që ta përkrahim këtë festival i cili ka më shumë se 10 vite që është duke u organizuar dhe besoj se ky festival do të vazhdoj edhe në vitet e ardhshme.

Fahrije Lushi Morina – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, kam një sugjerim ose vërejtje që herrave të tjera këto materiale të i kemi paraprakisht sepse neve mundet të na interesoj që të kemi informacione më të detajuar rreth këtij festivali, kurse ne tani nuk mundemi që ta bëjmë diskutimin përderisa nuk e kemi materialin, prandaj ju lutem që ta keni parasysh këtë vërejtje.

Kryesuesi - E nderuar ne që në fillim e cekëm se kjo pika ka ardhur sepse është urgjente, por në kuvend do ta keni si pikë të kompletuar me material.

Nënkryetari – E nderuara znj. Fahrije Lushi shqetësimi juaj është me plotë të drejtë edhe ne pajtohemi me ju por për shkak të ngutshmërisë së kësaj kërkesa nuk kemi mundur me ju sjellë propozim vendimin. Ne si kuvend kemi me i ndarë vetëm mjetet për organizim të këtij festivali, kurse për çështjet e tjera se si do të shkoj festivali për atë është kryesia e fshatit dhe kryesia e kësaj shoqate e cila merret me organizimin e këtij

festivali në bashkëpunim me Komunën e cila e ka formuar një këshill organizativ ku më në detaje bësoj se do të informoheni në Mbledhjen e Kuvendit Komunal.

Florida Krasniqi – Mendoj se organizatorët e këtij festivali është dashur të na sjellin një specifikacion dhe të cekin se ku do të shkojnë këto mjete dhe në këtë mënyrë ne të jemi të informuar.

Nënkryetari - Pasi të kryhet ky festival e nderuar znj. Florida Krasniqi ata do na sjellin raportin e shpenzimeve për këtë ata e kanë edhe obligim që të raportojnë para Kuvendit sepse Kuvendi i ka ndarë mjete për organizim të këtij festivali. Po ashtu mirë është edhe nëse e sjellin një specifikacion se ku do të shpenzohen mjetet, pajtohem plotësisht me ju.

Kryesuesi – E qes në votim pikën e gjashtë Shqyrtimin e Propozim Vendimit për ndarjen e mjeteve për Festivalin Folklorik Kombëtar “Anadrinia Jehon” Dejnë”; Konstatoj se në mënyrë unanime është aprovuar pika e 6 (Gjashtë) e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e fundit të rendit të ditës për mbledhjen e sodit:

7. Të Ndryshme.

Nëse nuk ka askush të shtoj diçka në pikën e fundit me kaq përfundoj mbledhja e KPF-së për sot ju falënderoj për pjesëmarrje, shihemi në mbledhjen e Kuvendit.

Mbledhje ka përfunduar në ora: 11:00

Procesmbajtësi,

Skender Hamza

K R Y E S U E S I

Afrim Dina